Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**13.06.2023**	**22.06.2023**	**2023/0389**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.06.2023, OE "Pro & Co Group SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0389, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË" me nr. të prokurimit: "214-22-10936-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurët hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **1 538 842,70** €.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së - Qëllimi,

3/8

AK ka shkelur nenin 6 të LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;

AK ka shkelur nenin 10 të LPP-së - Mjetet për promovimin e Transparencës;

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së Kriteret për Dhënien e Kontratës;

AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

AK ka shkelur nenin 65 të LPP-së - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve;
AK ka shkelur nenin 71 të LPP-së - Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik;
AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të RRUOPP-së;

AK nuk i ka respektuar kërkesat e dosjes se tenderit të përcaktuara paraprakisht.

AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Te pa kënaqur me propozimin per anulim te aktivitetit te prokurimit te publikuar me daten 01.06.2023, ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË** me nr. te prokurimit: **214-22-10936-5-1-1 dhe** Nr. i brendshëm: **214-22-176-511,** ne afatin ligjor konform nenit 109, te LPP-se, ne afatin e paraparë ligjor paraqesim ankese:

Për shkak se AK- **POLICIA E KOSOVËS,** gabimisht i eshtë referuar dispozitave ligjore dhe gjendjes faktike.

PRETNDIMI ANKIMORE 1

Autoriteti Kontraktues – AK **POLICIA E KOSOVËS** na ka derguar leter standarde per tenderusesin e eleminuar ne mënyrë te kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

AK ne letrën standarde te dërguar me datën 24.05.2023 na ka eliminuar me arsyetimin e mëposhtëm: *"Inxhinieri i ndërtimtarisë z. Sedat Ahmeti, nuk e arrin përvojën e punës pas diplomimit dhe ne oferte për inxhinierin z. Shaqir Idrizi, nuk eshtë dorëzuar kontrata e punës..."*

Te njejtin arsyetim te eleminimit kompania jone me daten 29.05.2023, e kemi kundërshtuar, përderisa AK – Policia e Kosoves, permes vendimit te dates 01.06.2023, refuzon kerkesen tone me arsyetimin se ing, z. Sedat Ahmeti, nuk permbush periudhen e pervojes se punes prej 5 viteve pas diplomimit.

Kompania jone "PRO & CO GROUP shpk, përmes ofertës ka dorëzuar Diplomën e z. Sedat Ahmeti, i diplomuar me daten 14 shtator 2017, rrjedhimisht e ploteson kerkesen e kualifikimit dhe te percaktuar nga AK, pasi qe hapja e ofertave per kete procedur te prokurimit eshte bere ne muajin nentor 2022, prandaj AK – Policia e Kosoves ne kundershtim me nenin 59, te LPP-se ka eleminuar oferten tone, duke i u referuat datës se marrjes se diplomës por jo edhe datës se diplomimit.

- **PROVE – Diploma e noterizuar.**

Ngjashem eshte vepruar edhe kundrejt ing z. Shaqir Idrizi, ku AK – Policia e kosoves potencon nuk i permbush kerkesat e kualifikimit meqe nuk e kemi ngarkuar kontraten e te njejtit ne e prokurim pot permes kerkeses per ri shqyrtim.

Inxhinieri i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, dhe te gjithë inxhinieret dhe stafi tjetër janë te përshkruar ne lista e stafit, listë e cila eshte e ngarkuar ne oferte poashtu te njëjtit janë te deklaruar si pjes e stafit tone ku si deshmi ne kemi prezantuar edhe listen e pagave te lëshuar nga ATK, kopjet e kontratave te punës, marrëveshjet e bashkëpunimit, rrjedhimisht ne si OE i plotesojme te gjitha kerkesat e kualifikimit, prandaj AK, Policia e Kosoves, perkunder obligimit ligjore per te aplikuar dispozitat e nenit 72, te LPP-se dhe nenit 10, te Udhëzuesit për prokurim publik, ne rast te dilemave te paraqitura përgjatë vlerësimit te ofertave ka mundur te kërkoi sqarim shtese, megjithatë, nuk i ka zbatuar te njejta dispozita por oferten tone ne menyre kunderligjore tenton ta eleminoi si te pa përgjegjshme.

AK – Policia e Kosovës, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ka kërkuar:

a) *Kërkesa 3- Operatori Ekonomik duhet te caktoj një menaxher të projektit me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtaris Konstruktiv ose inxhinier i arkitektures (apo master*

jo bachelor), i cili duhet te ketë provoj pune minimumi 5 vite pas diplomimit , kompania nuk ka ofruar kontratë apo parakontrat per ing. Shaqir Idrizi sipas deshmive të kërkuara nga ana e AK.

b) *Kërkesa 3- Operatori Ekonomik duhet te caktoj një menaxher të projektit me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtaris Konstruktiv ose inxhinier i arkitektures (apo master jo bachelor), i cili duhet te ket provoj pune minimumi 5 vite pas diplomimit, ing i prezantuar nga kompania Sedat Ahmeti nuk ka përvojë pune 5 vite pas diplomimit duke ju referuar rregullores 001/2023 per prokurimin publik nenit 10.1 CV-ja e dorzuar nuk permbush kerkesat.*

Përgjigje për piken A)

z.Shaqir idrizi eshte punëtor i rregullt i kompanisë me kontrat nga data 04.05.2022 i cili vazhdon të jetë ende i punësuar ne kompanin tonë, ne mund tua deshmojm me kontratë Valide te noterizuar para dorzimit te ofertes si dhe me listë të pagave në ATK.

PROVE - Bashkangjitur i gjeni dheshmit Kontraten e punës , Listen e pagave te cilat keni mundur ti kerkoni me Leter standarde per sqarim.

Pergjigjje pika B)

Cv e inxhinierit z. Sedat Ahmeti ,i përmbush te gjitha kerkesat sipas kriterit te ofruar nga AK. Po ashtu kemi ofruar Dokumente shtes me anë të kërkeses per Rishqyrtim me date 27.02.2023 , referencat me vite per provojen e punës , Andaj arsyetimi juaj nuk vlen pasi qe në Dosje te tenderit kërkesa ka qenë

Dëshmi 2-Lista e stafit profesional duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe dëshmitë për secilin inxhinierë si ne vijim • Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, • Diploma e inxhinierëve përkatës sipas lëmis së kërkuar e noterizuar, • CV-it- e inxhinierëve, • Referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës),

Pra sipas kerkeses ne kemi ofruar dokumentet e kerkuara dhe Arsyetimi juaj për eleminim bije ndesh me kërkesen e AK ne dosje te tenderit. Bashkangjitur i gjeni Deshmitë të cilat keni mundur te kerkoni sqarim në baz të nenit 69 të LPP

AK nuk e ka marre mundin qe ti shikoj dokumentacionin te cilin e kemi ofruar në kërkesen per rishqyrtim me datë 27.02.2023.

PRETNDIMI ANKIMORE 2

Ndërsa per operatoret ekonomik me qmim më të lirë se ne, te njëjti kane prezantuar oferta te pa përgjegjshme ne raport me kërkesat kualifikuese te përcaktuara ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontrate.

Lidhur me oferten OE NPNSH Euroing Shpk, oferta e tij eshte e papergjegjshme sa i përket edhe ndërhyrjes ne formularin e pershkrimit te çmimit ku ka modifikuar paramasen dhe parallogaris.

Neni 44.3 te Rregullores për prokurim publik përcakton:

> *"Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale* ***të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde****. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header" apo kudo tjetër në dokumentet standarde".*

Kompania jone pikërisht për ketë qeshje ka kërkuar nga KRPP, interpretim ligjore dhe KRPP, përmes përgjigjes dehe interpretimit te *dt .02.03.2023., konstatohet* ***pa përgjegjshmëria*** *e te njëjtit OE.*

PROVEKerkesa per interpretim si dhe Interpretimi KRPP-se i dt. 02.03.2023

Po ashtu edhe OE, tjetër pjesëmarrës ne ketë procedurë te prokurimit "Astraplan", i njëjti ka prezantuar oferte te pa përgjegjshme dhe te konstatuar nga vet AK – Policia e Kosovës.

Prandaj, bazuar ne faktet dhe provat e prezantuara si me larte AK – Policia e Kosovës, përgjatë vlerësimit dhe ri vlerësimit te ofertave, nuk ka respektuar dispozitat ligjore dhe

parimet kryesore te LPP-se.

- Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ku Qëllimi i këtij neni eshtë qe Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, kurse AK ne te kundërtën hapur na ka diskriminuar kompaninë tone.

- Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë komfor nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.
- Po me propozimin për anulim te procedurës se prokurimit me arsyetim te tille janë shkelur dispozitat e nenit 62, te LPP-se, pasi qe asnjeri nga kushtet ligjore nuk eshtë konsumuar për ta anuluar procedurën e prokurimit, rrjedhimisht sipas nenit 97, pika k), përcakton se anulimi i aktivitetit te prokurimit ne kundërshtim me nenin 62, te LPP-se konsiderohet si shkelje e rende.

Prandaj bazuar ne atë qe u përshkrua dhe shkeljet e AK-se ne ketë aktivitet te Prokurimit te nxjerrët:

VENDIM

I. **Te aprovohet,** ne tërësi e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: ***Pro& Co Group Shpk*** Lidhur me aktivitetin e prokurimit: NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË me numër te prokurimit: 214-22-10936-5-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 214-22-176-511 te iniciuar nga AK- POLICIA E KOSOVËS.

II. **Te anulohet ,** propozimi i AK- Policia e Kosovës, njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit dhe lënda te kthehet ne **RI VLERESIM**

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kerkesa 3-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një menaxher të projektit me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – konstruktiv ose inxhinierë i arkitekturës (apo master jo bachelor), i cili duhet të këtë përvojë pune minimumi 5 vite pas diplomimit	**Deshmi 3-Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit (mundet te jete njeri nga stafi profesional i prezantuar) - i nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, diploma e noterizuar, CV dhe referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës)**
Kerkesa 4-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një udhëheqës te punimeve me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (apo master jo bachelor), i cili duhet të këtë përvojë pune minimumi 5 vite pas diplomimit	**Deshmi 4-Vendim me shkrim për caktimin e udhëheqësit te punimeve - i nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, diploma e noterizuar , CV dhe referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës)**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratë Publike
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave
Ministry of Internal Affairs and Public Administration

Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë /
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Ndërtimi i Stacionit Policor Veri Prishtinë

Nr. i Prokurimit:	**214-22-10936-5-1-1**
Nr i brendshëm	**214/22/176/511**

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[2]
1.	" MABCO CONSTRUCTIONS " SH.P.K., Azizs Abrashi 140, 10000, Zona Industriale - Prishinet, Kosovë	2,179,743.82 €
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik LIMITPROJECT SH.P.K.; DELTA - CCD SH.P.K.; Rinesa SH.P.K., Prishtine,Hyzri Talla, Qendra Tregtare, p.n. 10000, Prishtine, Kosovë.	1,647.348.74 €
3.	Astraplan SH.P.K., K.E DIELLIT RR. M.GRADICA H.5/6, 10000, PRISHTINE, Kosovë.	1,388,888.89 €
4.	Pro & Co Group SH.P.K., Rr.Marigona Residenc Llapllasellë p.n, 10500, Graqanicë, Kosovë.	1,436,569.47 €
5.	Çeta -General Invest Group, TRUBUHOC, 31000, ISTOG, Kosovë.	1,427,427.00 €
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik: " HIDRO PROJECT " SH.P.K.; ,, ENGRUP " SH.P.K., Bill Klinton,14-1, -, PRISHTINË, Kosovë.	1,188,259.11 €
7.	NPN EUROING SH.P.K., XËRXË, 21000, RAHOVEC, Kosovë.	1,367,396.72 €
8.	Olti Trasing SH.P.K., Bill Klinton, 10000, PRISHTINE, Kosovë.	1,448.000.00 €
9.	"AL-BER" SH.P.K., Pecan, Suhareke, 23000, Suhareke, Kosovë	1,224,268.14 €

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Policia e Kosovës Anulon aktivitetin e prokurimit pasi nuk kemi asnjë ofertë të përgjegjshme.

Data: 23/05/2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: Artan Fejza

[1] Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde te njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojes).
[2] Në rast të procedurave të kufizuara/procedurave konkurruese me negociata t'i bashkangjiten letrat standarde të njoftimeve: B43 dhe B44.(shto letra standarde sipas nevojës), derisa kolona "Vlera totale e ofertave" nuk plotsohet me te dhena.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Pro & Co Group SH.P.K.**

Autoriteti Kontraktues –POLICIA E KOSOVËS gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar 1 538 842,70 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët.**

Autoriteti Kontraktues-POLICIA E KOSOVËS përmes B58-Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 23.05.2023, Anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se nuk kemi asnjë ofertë të përgjegjshme.

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit të operatorit ekonomik ankues Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 26.04.2023 ku AK -POLICIA E KOSOVËS, ka potencuar*:* Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm; OE është i papërgjegjshëm pasi nuk ka plotësuar pikat në vijim:

Kërkesa 3-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një menaxher të projektit me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – konstruktiv ose inxhinierë i arkitekturës (apo master jo bachelor), i cili duhet të këtë përvojë pune minimumi 5 vite pas diplomimit.

Kompania nuk ka ofruar kontratë apo para kontratë për ing.Shaqir Idrizin sipas dëshmive të kërkuara nga ana e AK.

Kërkesa 4-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një udhëheqës te punimeve me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (apo master jo bachelor), i cili duhet të këtë përvojë pune minimumi 5 vite pas diplomimit.

Ing.i prezantuar nga kompania Sadet Ahmeti nuk ka përvojë pune 5 vite pas diplomimit dhe duke ju referuar rregullores 001/2023 për prokurim publik nenin 10.1 ku thotë:

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

OE ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim me datë 29.05.2023. AK me datë 01.06.23, nëpërmjet vendimit refuzon kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues, pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 10, 59, 60, 62, 65, 71, 72 dhe 108/A të LPP-së, dhe dispozitat e Rruopp-së dhe kërkesat e dosjes se tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK e ka eliminuar pa të drejte me arsyetimin se kompania nuk ka ofruar kontratë apo para kontratë për ing.Shaqir Idrizin sipas dëshmive të kërkuara nga ana e AK, e**kspertja shqyrtuese** sqaron se AK tek kërkesatKapaciteti teknik dhe profesional pika 9.1 & 9.2 ka kërkuar:

Kerkesa 3-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një menaxher të projektit me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – konstruktiv ose inxhinierë i arkitekturës (apo master jo bachelor), i cili duhet të këtë përvojë pune minimumi 5 vite pas diplomimit	**Deshmi 3-Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit (mundet te jete njeri nga stafi profesional i prezantuar) - i nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, diploma e noterizuar, CV dhe referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës)**

OE ankues me tender ka dorëzuar listën me stafin profesional, ku në këtë liste është përshkruar eksperienca dhe pozita në kompani e stafit, Ing. Shaqir Idrizi, sipas kësaj liste ka 15 vite përvojë pune. Me ofertë për ketë inxhinier është bashkëngjit vendimi mbi emërimin si menaxher i projektit, diploma, cv dhe referencat, por nuk ishte bashkangjitur edhe **"kontrata ose para kontrata e punese valide me punëdhënësin"** siç ka qenë kërkesa e AK-së. Mirëpo, OE ankues me rastin e parashtrimit të kërkesës për ri shqyrtim të datës 29.05.2023, kishte prezantuar listën e deklarimeve të pagave për punëtoret në ATK për vitin 2022 dhe tremujorin e parë të vitit 2023 dhe në mesin e tyre ishte i deklaruar edhe ing. Shaqir Idrizi, kishte bashkangjitur Kontratën e punës për kohë të caktuar në mes punëdhënësit PRO&Co Group sh.p.k dhe të punësuarit Shaqir Idrizi, ne nenin 4 po të kësaj kontrate ceket se i punësuari themelon marrëdhënie pune në kohen e caktuar duke filluar nga 4 Maj 2022 deri me 04 Maj 2023, kjo kontratë është nënshkruar mes palëve dhe e noterizuar pranë noterit më numër rendor 3860/2022, noterizuar me datë 09.06.2022. Po ashtu ishte bashkangjitur edhe kontrata e noterizuar pranë noterit me numër rendor 1485/2023 me datë 08.03.2023, ku përmes kësaj kontrate i vazhdohet marrëdhënia e punës deri me datë 31.12.2023. Andaj, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se duke pasur parasysh që hapja e ofertave ishte bërë me datë 29.11.2022, ndërsa kontrata e noterizuar tek noteri është bërë me datë 09.06.2022 (para publikimit të njoftimit për kontratë dhe para hapjes së ofertave) për ing. Shaqir Idrizi, si dhe vërtetohet se ky inxhinier është deklaruar në listën e pagave në ATK, **ekspertja shqyrtuese** konsideron se AK është dashur që ti pranoj këto dokumente për arsye se lista e pagave të punëtorëve e dëshmuar me vulë të ATK-së vërteton se ky inxhinier kishte qenë i punësuar dhe deklaruar në ATK-së si punëtor i këtij biznesi. Nëse analizohet kjo listë e pagave, shihet që deklarimi i këtij inxhinieri është konform kontratës së vitit 2022, ku sipas kësaj kontrate Shaqir Idrizi ishte punësuar në muajin maj 2022 dhe deklarimi i këtij punëtori në ATK ishte bërë po në muajin maj 2022. Andaj, pretendimi i OE ankues është i **bazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK e ka eliminuar pa të drejte me arsyetimin se ing. Sadet Ahmeti nuk përmbush periudhën e përvojës se punës prej 5 vite pas diplomimit, tutje OE potencon se AK ju referuar datës se marrjes se diplomës e jo edhe datës se diplomimit.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK tek kërkesatKapaciteti teknik dhe profesional pika 9.1 &

9.2 ka kërkuar:

Kerkesa 4-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një udhëheqës te punimeve me profesion inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (apo master jo bachelor), i cili duhet të këtë përvojë pune minimumi 5 vite pas diplomimit	**Deshmi 4-Vendim me shkrim për caktimin e udhëheqësit te punimeve - i nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, diploma e noterizuar , CV dhe referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës)**

OE ankues përmes ofertës ka dorëzuar listën me stafin profesional, ku në këtë listë është përshkruar eksperienca dhe pozitat e stafit në kompani, Ing. Sadat Ahmeti sipas kësaj liste ka 5 vite provoj pune. Gjithashtu për Ing. Sadat Ahmeti, është bashkangjitur diploma, kontrata, vendimi i MASHT-për njohje të diplomave dhe kualifikimeve të arsimit të lartë të fituara jashtë Republikës së Kosovës, CV, referencat dhe vendimi për caktimin e udhëheqësit të punimeve. Sipas diplomës së prezantuar, z.Sadat Ahmeti me datën 14 shtator 2017 ka diplomuar, kurse data e lëshimit të diplomës mban datën 14 korrik 2018. Andaj, **ekspertja sqaron** se data e lëshimit të diplomës nuk lidhet me datën e diplomimit sepse në pjesën poshtë emrit dhe mbiemrit të diplomuarit ceket se "me 14 shtator 2017 i ka përmbushur të gjitha kërkesat për lëshimin e kësaj diplomë..."Andaj pretendim i OE ankues në këtë pikë është **i bazuar**.

Sa i përket konstatimit të AK në lidhje me përvojën e punës, ku ka cekur se ky inxhinier nuk i posedon 5 vite përvojë pas datës së diplomimit dhe referencat e dorëzuara me kërkesën për ri shqyrtim dallojnë nga referencat fillestare të dorëzuara me tender, **ekspertja shqyrtuese sqaron** se në CV e këtij inxhinieri te dorëzuar me tender ceket se ka përvojë pune tek:

DEKOR Group SHPK Prishtinë 2010 – 2016;

Globus Construction-S Gjilan 2018 – 2020;

DUA ARCH SHPK 2020;

LUNARI Compani 2019 – 2020 – 2021;

EURO TRANS 2018 - 2019;

Pro & Co Group SH.P.K. 2017 – 2021

Studio e Projektimit Urbanistik "Vizion Project" 03.01.2014 – 31.12.2017;

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se kërkesë e AK-së ka qenë që për përvojën e punës të dëshmohet me referenca mbi përvojën e punës (***në referenca duhet të jenë të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës)***. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë të DT-së dhe CV së bashkangjitur për këtë inxhinier dhe referencave të bashkangjitura, **ekspertja shqyrtuese** sqaron si më poshtë:

Punëdhënësi "DEKOR Group" është para datës së diplomimit dhe kjo përvojë e punës nuk është sipas kërkesës së AK-së;

Për përvojën tek GLOBUS Construction SHPK është pas datës së diplomimit por nuk është bashkangjitur referencë;

Për përvojën e lëshuar nga "DUA ARCH" SHPK është lëshuar referenca për periudhën 05.05.2020 deri me 31.05.2021, ku nga kjo referencë rezulton se tek ky punëdhënës ka përvojë 13 muaj;

Për punëdhënësin LUNARI Compani nuk është bashkangjitur referencë;

Lëshuesi i referencës "PRO & CO" ceke se Sedat Ahmeti është i angazhuar në kompaninë e tyre si inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë por në këtë letër referencë nuk saktësohet periudha apo vitet e punës ashtu siç është kërkesa e DT-së por vetëm projektet e realizuara që Ing. Sadat Ahmeti ka udhëheq punimet në këto projekte.

Po ashtu **ekspertja shqyrtuese** ka analizuar edhe referencat e dorëzuara më kërkese për rishqyrtim nga OE ankues, ku pas shqyrtimit të këtyre referencave rezulton se referenca e lëshuar nga "DUA ARCH" dallon nga referenca fillestare e dorëzuar me tender (për nga numri i projekteve). Pastaj sa i përket përvojës tek "LUNARI", me tenderin e dorëzuar mungonte referenca ndërsa në CV ceket periudha për vitet 2019, 2020 dhe 2021, ndërsa me kërkesën për rishqyrtim ishte bashkangjitur referenca e lëshuar nga LUNARI për vitet 2019, 2020 dhe 2021. Po ashtu me kërkesën për rishqyrtim është bashkangjitur edhe referenca e lëshuar nga Vizion Project për periudhën "nga 01.01.2018 gjer më tani". Ndërsa për referencën e lëshuar nga Pro & Co Group dhe të dorëzuar me kërkesën për shqyrtim, tani në këtë referencë ceket se Sedat Ahmeti ka bërë mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e projekteve nga janari 2017 deri në nëntor 2022.

Lidhur me këtë referencë të dorëzuara me kërkesën për rishqyrtim, **ekspertja** vlerëson se

konstatimi i AK-së është i saktë pasi referenca e dorëzuara herën e dytë dallon nga ajo e dorëzuara me tender. Pasi letër referencën e lëshuar nga Pro & Co Group në herën e parë nuk ceket periudha e punës siç ka qenë kërkesa e dosjes së tenderit që të jenë të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës, kurse herën e dytë është saktësuar periudha e punës (janari 2017 deri në nëntor 2022). Ndërsa tek kompania Globus Construction-S Gjilan edhe pse ceket në CV se Ing. Sadat Ahmeti ka përvojë pune por nuk ka bashkangjitur referencë siç ka kërkuar AK.

Meqenëse në CV dhe me disa referenca është prezantuar informacioni lidhur me përvojën e punës, të z.Sadat Ahmeti dhe ligji i prokurimit lejon sqarime edhe plotësimin e dokumenteve që mungojnë andaj autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit konform nenit 72 të LPP-së do duhet të kërkonte sqarime shtesë lidhur me përvojën punës të inxhinierit Ing. Sadat Ahmeti.

Lidhur me pretendimi e OE ankues kundrejt ofertës së operatorit ekonomik NPN Euroing shpk se ka ndërhy në formularin e përshkrimit të çmimit ku ka modifikuar paramasen. Tutje OE potencon se për ketë çështje ka kërkuar nga KRPP interpretim ligjor dhe KRPP përmes përgjigjes dhe interpretimit të dt. 02.03.2023 konstatohet pa përgjegjshmëria e te njëjti OE. Për ketë pretendim ankimor ekspertja shqyrtuese sqaron se ka raport të ekspertizës me nr.356-2023.

Lidhur me pretendimi e OE ankues kundrejt ofertës së operatorit ekonomik Astraplan i njëjti ka prezantuar ofertë te pa përgjegjshme dhe të konstatuar nga vet AK –Policia e Kosovës. Për ketë pretendim ankimor ekspertja shqyrtuese sqaron se ka raport të ekspertizës me nr. 373/23.

Provë: Diploma e Sadat Ahmeti , Lista e pagave të deklaruar në Atk për vitin 2022 dhe 2023, Kontrata e punës e Shaqir Idrizit dhe Akti noterial me nr.3860/2022 i dt; 09.06.2022

INTERNATIONAL UNIVERSITY
Brčko District
Bosnia and Herzegovina

INTERNATIONAL UNIVERSITY

FACULTY OF MANAGEMENT

DIPLOMA

of the acquired scientific title

Rector of the University and Dean of the Faculty of Management confirm by their signatures and University seal that

Sedat (Ukshin) Ahmeti

born on 2 July 1985, place of birth Gjilan, Municipality of Gjilan, defended master's thesis under the title Stalle and stoire of multi-storey buildings, on 14 September 2017 on the Faculty of Management in Brčko and that he met all the requirements for obtaining diploma of the acquired scientific title of:

MAGISTER
OF CONSTRUCTION INDUSTRY

In Brčko 14 July 2018
Number: 123-MM/18B

DEAN
Doc. dr Saša Bešlić

RECTOR
Prof. dr Velimir Sotirović

IUBD 002E37E

PRO & CO GROUP
CONSTRUCTION COMPANY
+383 45 77 77 57

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

KONTRATË PUNE PËR KOHË TË CAKTUAR

Neni 1

Me këtë Kontratë: **PRO & Co Group sh.p.k** me numër unik identifikues **811092254**, me seli në: Rr. Marigona Residenc, Llapllasellë,Graçanice, drejtori Kenan Emini (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë kontratë pune me: **Shaqir Idrizi** me numer personal: [redacted] (në tekstin e mëtejshëm: I punësuari).

Neni 2

I punësuari do të kryej këto detyra të punës: **Inxhinier i Ndërtimtarisë – Konstruktiv**

Neni 3

I punësuari do të kryejë punët në: **Pro & Co Group sh.p.k**

Neni 4

I punësuari themelon marrëdhënie pune, në: kohë të caktuar, duke filluar nga: **04 Maj 2022** deri me **04 Maj 2023**.

Neni 5

Neni 24

Pas njoftimit me përmbajtjen e Kontratës, kjo Kontratë nga palët kontraktuese u nënshkrua më datën: **04 Maj 2022**, në: **Graçanicë**, **në: 2 kopje autentike nga 3 faqe**, nga të cilat, secilës palë i mbeten nga 1 kopje.

Punëdhënësi:

SH.P.K. PCG PRO & CO GROUP GRAÇANICË

Pro & Co Group sh.p.k

I Punësuari:

Shaqir Idrizi

REPUBLIKA E KOSOVËS

NOTER:

NASER S. PAJAZITI

VITI

Numri rendor: 3860/2022

Unë,NOTER –Naser Pajaziti ,me zyrë noteriale në Viti,Rr."Xhemajl Ademi" nr.54,----------
Vërtetoj se **"Pro & Co Group Sh.P.K., me seli në Llapllasellë rruga "Marigona----------**
Residenc" p.n. , identifikuar sipas Çertifikatës së biznesit me nr. unik identifikues---
811092254, i përfaqësuar nga Drejtori: Zt. Kenan Emini, i lindur në Viti,Komuna e----
Vitisë,më [redacted], me vendbanim të përhershëm në Zhiti,Komuna e----------
Vitisë,identiteti i të cilit konstatohet nga Letërnjoftimi me nr. personal [redacted],--
të lëshuar nga RKS-MPB me datë 12.01.2016 dhe,----------
2.Zt.Shaqir Idrizi, i lindur më 08.02.1974 në Buzovik,Komuna e Vitisë,shtetas i ---------
Republikes së Kosovës,identiteti i të cilit konstatohet nga Letërnjoftimi me numër-----
personal [redacted], me vendbanim në Viti rruga "Daut Zenuni" p.n.----------
nën praninë time kanë nënshkruar me dorë të vetë këtë "Kontratë Pune Për kohë Të --------
Caktuar" dhe është vërtetuar me vulën e firmes " Pro & Co Group Sh.P.K., dhe ----------
Sh.Idrizi.----------
Identitetin e të -lartëpërmendurve e kam vërtetuar në bazë të Leternjoftimve, me nr.---------
[redacted] dhe [redacted], të lëshuar nga MPB të Kosovës ,që më janë prezentuar.- -------
Nënshkrimi i të lartëpërmendurve në dokumentin e cekur dhe vula janë vënë në çdo faqe ---
në prani të Noterit dhe janë autentik.----------
Shpenzimet janë paguar nga pala në vlerë prej 9.80 euro+ 18%Tvsh bazuar në tarifën nr 02,--
bazë për pagesën shërbimit të noterëve.----------
Bazuar në Ligjin mbi Noterinë ,Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen dhe nuk obligohet nese-
pala ka apo jo të drejtë në lidhjen e kësaj pune ka përmbajtjen ky dokument.----------
Në Viti,me **Nëntë Qershor Dymijë e Njëzet e Dy.**----------

NOTERI

Naser S. Pajaziti

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosovo / Tax Administration of Kosovo
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: ATK
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 574/2023
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 2
Data / Datum / Date: 02.02.23
Hyrëse
DTM PRISHTINËJA

LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË

ATK-KS\sduriqi 2/2/2023 2:55:36 PM

NR FISKAL	811092254
EMRI I KOMPANISË	Pro & Co Group SH.P.K.
ADRESA	p.n.
LLOJI I BIZNESIT	SH.P.K.
QENDRA TATIMORE	DTM
VITI	2022

					MUAJT											
NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIM	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
50	SHAQIR	IDRIZI	[redacted]	PO	-	-	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË

ATK-KS\bazemi 4/20/2023 1:37:14 PM

NR FISKAL	811092254
EMRI I KOMPANISË	Pro & Co Group SH.P.K.
ADRESA	p.n.
LLOJI I BIZNESIT	SH.P.K.
QENDRA TATIMORE	DTM
VITI	2023

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosovo / Tax Administration of Kosovo
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: ATK
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 1862/2023
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 3
Data / Datum / Date: 20.04.23
Dalëse
DTM PRISHTINËJA

54	SHAQIR	IDRIZI	[redacted]	PO	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-

Prandaj ne mbështetje te asaj qe u përshkrua si më lartë, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në Ri Vlerësim.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Pro & Co Group SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Majlinda Bedrolli